

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

YOUR EVERYDAY SUCCESS sh.p.k

Sot, me date **21.02. 2025** (dymije e njezete e pese) ne Tirane u mbajt ky statut dhe akt themelimi midis :

1. Zj. Ester Kalaveri, shtetase Shqiptare , lindur më 15.05.2005 në Kruje , Shqiperi me numer personal K55515012A , me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
2. Z. Egi Skenderaj, shtetas Shqiptar, lindur më 16.11.2005 ne Shqipëri, me numer personal K51116078G , me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

KAPITULLI I

EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI

NENI 1

Emri

- 1.1. Shoqëria do të quhet **YOUR EVERYDAY SUCCESS** shpk . (Këtu e më poshtë “Shoqëria”)
- 1.2. Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 1.3. Shoqëria ka logon dhe vulën e saj zyrtare.

NENI 2

Selia

- 2.1. Selia e shoqërisë do të jetë ne adresen Rruga Muhamet Deliu, Nd. 9, H21, Ap. 25, Dajt , Linze, 1040, Tirane.

NENI 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e palimituar.

Neni 4

Objekti

4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

Tregti me pakice te veshjeve te ndryshme

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR

NENI 5

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 lekë (njëqindmije lekë) i përbërë nga 2 kuota.

Kapitali i shoqërisë përbehet nga 2 (dy) kuota, me vlere nominale 100,000 leke

Zj. Ester Kalaveri dhe Z. Egi Skenderaj zotërojnë nga 50% te kapitalit te shoqërisë ne vlere 100,000 lekë (njeqindmije lekë).

Kapitali mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve themelues. Kuota e Pjesmarresve ne kapital jane te gjitha te emruara dhe te pa ndashme. Kapitali eshte teresisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 6

Ortaku qe ka ndermend te shesi kuotat e tij teresisht, apo pjeserisht duhet me pare te njoftoje ortakun tjeter te shoqerise. Ortaku tjeter ka te drejten e blerjes se pare. Kete te drejta ortakut duhet ta ushtroje Brenda 30 Diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mos ushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortakut qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emerin e bleresit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se sa ato te afruara ortakut tjeter te shoqerise.

NENI 7

Kapitali i shoqërisë përbehet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bere, mjetet e xhiros, pasuri te luajtshme ose te paluajtshme etj te nevojshme për ushtrimin e aktivitetit te shoqërisë.

NENI 8

Kuotat e kapitalit janë te pasqyruara dhe te regjistruara ne librat e llogarisë te shoqërisë.

NENI 9

Heqja dore e ortakut nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po kështu ai fiton dhe te drejtat qe janë krijuar para largimit te tij .

NENI 10

Fitimet që realizohen gjatë veprimtarisë dhe që konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve në proporcion me përqindjen e kapitalit të investuar, por kudoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar në ligj.

NENI 11

Shoqëria tregtare "YOUR EVERYDAY SUCCESS" sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo mund të blejë dhe të shfrytëzojë të drejta të tjera, material ose jo material, duke përfshirë edhe të drejtën për shitjen e pasurive së vet tek të tjerët.

Në Republikën e Shqipërisë Shoqëria tregtare "YOUR EVERYDAY SUCCESS" sh.p.k. gëzon të drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj në përputhje me legjislacionin në fuqi.

NENI 12

Shoqëria tregtare "YOUR EVERYDAY SUCCESS" sh.p.k. vepron në regjimin e pronës private dhe merr përsipër të drejtat e detyrimit vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues të shoqërisë, mbartin rrezikun e veprimtarisë së shoqërisë, vetëm në nivelin e kuotave të kapitalit të investuar në të. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet që ortakët kanë pasur para se ajo të krijohet.

KAPITULLI I III

ORGANET DREJTUESE

NENI 13


13.1 Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë :

ORTAKET:

1. Ester Kalaveri me numer ID K55515012A

2. Egi Skenderaj me numer ID K51116078G

13.2 Ortakët kanë të drejtë të administrojnë aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë së saj, duke përfshirë edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund të kryej, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Kanë të drejtë të marrin dijeni për rezultatet ekonomiko



financiare ne çdo faze te aktivitetit te saj. Kane te drejte te marrin pjese vete ose me ane te përfaqësuesve ne këtë aktivitet.

13.2 Ortaket kane te drejte te tërheqin te gjitha dokumentet kryesore te shoqerise per tre vjetet e fundit

13.3 Ortaket kane te drejte te heqin dore nga shoqeria dhe mund te shesin pjesen e kapitalit te tyre ne perputhje me kushtet qe i lejon statute dhe ligji.

13.4 Ortaket ne perputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjislacionin ne fuqi kane, te drejte qe ne te njejten kohe te jene ortake edhe ne shoqeri te tjera.

13.5 Ortaket rezervojne te gjitha te drejtat sipas ligjit Tregtar

ASAMBLEJA

NENI 14

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor. Ajo mblidhet sa here e shohin te arsyeshme ortaket, por domosdoshmerisht per te miratuar bilancin vjetor te shoqerise. Asambleja i merr vendimet e ortakeve, pervec rasteve te parashikuara ne statut.

NENI 15

Asambleja vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, shtimin ose pakesimin e kapitalit, per emerimin e organit administrativ, per drejtimet kresore te veprimtarise se shoqerise, per pushimin apo rritjen e veprimtarise se shoqerise.

NENI 16

Administrator i shoqerise YOUR EVERYDAY SUCCESS shpk do te jete :

Z. Egi Skenderaj i datelindjes 16.11.2005, me numer ID K51116078G me afat 5 vjecar.

NENI 17

Administrimi i shoqërisë

17.1 Administratori ka te gjitha te drejtat dhe fuqite per drejtimin e zakonshtëm te shoqërisë, me qellim qe te arrije objektivat e saj, përveç atyre qe ligji ia atribuon ortakeve.

17.2 Administratori përfaqëson shoqërinë ne mardhenie me te tretet si dhe para organeve te administratës dhe atyre gjyqesore.

17.3. Administratori përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj te treteve për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit apo për detyra të kryera gjatë administrimit. Ortaku ka të drejtë të ngrej padi ndaj administratorit.

17.4 Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakut, kanë të drejtë të veprojnë, firmosin pranë çdo organi administrativ, bankë të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.

17.5 Shoqëria administratohet nga pakten 1 (një) dhe maksimumi 3 (tre) administratorë, të cilët qëndrojnë në detyrë deri në revokimin apo dorëheqjen për një periudhë maksimale prej (5) vjetesh.

17.6. Çdo administrator do të ketë të drejtë për rimbursimin e shpenzimeve të bera prej tij për llogari të shoqërisë.

17.7 Kur administrator i shoqërisë rezultojë i suksesshëm në punën e tij dhe në rezultatin financiar të kompanisë atëherë ortakët vendosin lidhur me shpërblimin që do t'i jepet atij në fund të vitit financiar.

NENI 18

Detyrat e Administratorit/ëve

Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe të drejta.

- Te mirë administrojë pasurinë e shoqërisë
- Te lidhë marrëdhënie me të tretet Brenda objektit të veprimtarisë së shoqërisë dhe kompetencave të caktuara nga ortakët.
- Te zbatojë rregullat e brendshme të shoqërisë
- Te shpërblejë demet që i vijnë shoqërisë si pasojë e veprimeve apo mos veprimeve të tij.
- Te paguhet për punën e kryer në bazë të marrëdhënies së bërë midis tij dhe ortakëve.
- Te marrë të dhëna e të bëjë propozime mbi gjithçka që ai e quan e dobishme për shoqërinë
- Te miratojë planin e llogarive ekonomike pas përpunimit të tyre dhe t'i paraqesë ato sipas rastit për miratimin përfundimtar nga ortakët
- Te bëjë propozimet përkatëse ortakëve kur lind nevoja për ndryshime në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- Te miratojë aktet normative që përcaktojnë aportet në gjirin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin e personelin
- Te përcaktojë strukturën e aparatit të shoqërisë dhe të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë.
- T'i propozojë ortakëve për krijimin e entiteteve strukturore të ndryshme si filial, degë e e përfaqësi në qytetet të tjera të vendit ose jashtë shtetit.
- Te përgatitë propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe t'i paraqesë ortakëve për miratim. Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtarë të komisionit të likuidimit si dhe të paraqesë propozimet për miratim për ortakëve.
- Te sigurojë zbatimin e përpikë të Vendimeve të Ortakëve.
- Te kryejë çdo detyrë tjetër që i ngarkohet nga ortakët e shoqërisë.

NENI 19
EKSPERTI KONTABEL

19.1 Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo viti financiar. Caktimi i tyre e bënë administrator.

19.2 Eksperti kontabël mban përgjegjësi për mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit të shoqërisë.

19.3 Ato përgjigjen për demet që i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

19.4 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

19.5 Nuk mund të ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesit, administratorët, personat që janë në gjini e krushqi deri në shkallën e katert. Po ashtu nuk mund të kryejë këto detyra përgjegjësat e syrave, filialeve e agjensive.

KREU III
MARRËDHËNIET E PUNËS
NENI 20

Marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave të punës. Për çështjet që kjo kontratë nuk i parashikon zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar në fuqi.

NENI 21

Për çdo mos marrëveshje që mund të lind midis palëve dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 22

Sekreti i punës


Te gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga shoqëria.

KAPITULLI I IV
VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT

NENI 23

Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti. Përjashtimisht Viti I parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon me 31 dhjetor të të një viti.



NENI 24

Inventari dhe llogarite vjetore.

Shoqëria do të mbaje një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore.

Në mbylljen e vitit financiar administrator harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogarite vjetore për vitin financiar.

NENI 25

Raportet vjetore

25.1 Në mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe eksperti kontabël harton inventarët dhe llogarite vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortaket.

25.2 Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

25.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortaket sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

NENI 26

Rezerva e domosdoshme dhe e nevojshme.

26.1 Nga fitimi i realizuar gjatë vitit financiar pasi zbriten humbet e vitit të mëparshëm, hiqet menjëherë një shumë e barabartë me 5 % (pese për qind) e fitimit të destinuar për formimin e fondit rezerve të quajtur "rezerve e domosdoshme".

26.2 Heqja nga fitimi për rezervën e domosdoshme pushon së qeni e detyrueshme kur kjo rezerve arrijë 10 % të kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur për një arsye çfarëdo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nën 10% e kapitalit.

26.3 Ortaket mund të vendosin edhe zbritje të veçante në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo për shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

NENI 27

Te ardhurat eventuale të ndjekura nga shoqëria çdo vit financiar janë të destinuara siç është vendosur nga ortaket duke i qëndruar në uljen 5 % që do të destinohet rezervës ligjore.

KAPITULLI V

MBYLLJA E SHOQËRISË, LIKUJDMI

NENI 28

Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

NENI 29

29.1 Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortakët caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimin dhe emrin "Shoqëri në Likuidim e sipër".

29.2 Likuiditori i emëruar nga ortakët menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vënë në dispozicion menjëherë ortakëve.

29.3 Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

NENI 30

Ortakët vendosin mbi rregulshmerinë e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuiditorit.

Ortakët mund të vendosin vetë realizimin e kësaj mbledhje, në rast se likuiditori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakëve ose të një mandatmbajtësi të caktuar prej tij.

NENI 31

Kur ortakët për shkak të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes dhe likuidimit e depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar Shoqëria regjistrohet prej tij.

DISPOZITET KALIMTARE

NENI 32

Dispozitat e fundit

32.1 Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozita e Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

32.2 Për efekt të interpretimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nënkuptohet Ligji nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare"

32.3 Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cenojnë vlefshmërinë e tij.

NENI 33

Gjykata kompetente.

Gjykata kompetente për zgjidhjen e të gjitha mosmarveshjeve dhe interpretimin e Statutit të Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 34

Hyrja ne fuqi

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga Ortaket.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

“ YOUR EVERYDAY SUCCESS “ sh.p.k.

Ester Kalaveri



Egi Skenderaj

